



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 68

Datë: 16. 10. 2021: Ora 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
 2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së,
 3. Aktivitetet e ZRPPC-së,
 4. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve përfundimtare të KVV-ve, për zgjedhjet lokale 2021.
 5. Të ndryshme.
-

Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi : E hapim mbledhjen e 68-të të KQZ-së dhe të fundit para zgjedhjeve , komisioni është në përbërje të plotë sipas rendit të ditës që e kemi para vetes kemi do të thotë një hyrje, aktivitetet e sekretariatit ,aktivitetet e zyrës ,shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve përfundimtare të KVV-ve për zgjedhjet lokale 2021 dhe të ndryshme, a ka propozim me diçka lidhur me rendin e ditës z. Buleshkaj urdhëroni ?

Ylli Buleshkaj: I nderuar kryesues, faleminderit shumë kërkoj që te pika “aktivitetet e zyrës” të futet si nën pikë “shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të zyrës për heqje të akreditimit të vëzhguesve”, se e kemi pranuar pak me vonesë informatën, por duhet ta shqyrtojmë sot dhe të marrim një vendim !

Kreshnik Radoniqi : Atëherë kush është për këtë rend të ditës ?

Me vota unanime miratohet rendi i ditës

Para se t’ia japim fjalën z. Ahmetaj dëshiroj dy tri fjalë fillimisht të ri përsëris mesazhin tim për ditën e zgjedhjeve. Pra, dua ti ftoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që të marrin pjesë masivisht në procesin e votimit duke shfrytëzuar të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar, vota juaj ka rëndësi të ka rëndësi të jashtëzakonshme sepse përmes votës ju do të zgjidhni përfaqësuesin që do të qeverisin me komunën tuaj për 4 vitet e ardhshme. Po ashtu, dua ti ftoj të gjithë anëtarët e këshillave të vendotimeve që të ju përmbahen ligjeve dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së në të kundërtën veprimet e kundërligjshme janë të dënueshme sipas kodit penal të Republikës së Kosovës. Në këtë heshtje zgjedhore dua të falënderoj edhe subjektet politike për fushatën e zhvilluar gjatë kësaj periudhë njëmuajore për të cilën nuk ka pasur asnjë incident më të vogël. Roli i subjekteve politike është i madh edhe për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor prandaj ftoj subjektet politike që të respektojnë detyrimet e tyre ligjore edhe gjatë ditës së zgjedhjeve , deri më tani jemi angazhuar maksimalisht që të dielën qytetarët të realizojnë të drejtën e tyre kushtetuese dhe që zgjedhjet të jenë të lira dhe demokratike dua të shpreh besimin së përmes angazhimit të përbashkët do të arrihet synimi që zgjedhjet të gëzojnë besimin e qytetarëve edhe njëherë si përfundim ftoj të gjithë qytetarët që ditën e nesërme të dalin në mënyrë masive në zgjedhje...

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të KQZ-së më lejoni të ju informoj lidhur me aktivitetet të cilat janë një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përgatitjet për ditën e zgjedhjeve, shkurtimisht më lejoni të ju njoftoj lidhur me periudhën e votimit jashtë vendit pra periudhë e cila ka filluar me 15 shtator dhe është mbyllur me 15 tetor dhe përgjatë kësaj periudhe kemi pranuar 5649 pako të supozuara me fletëvotime pra të gjitha janë tërhequr nga postat postat zyrtare, qendra tranzitore si dhe posta tjera të shpejta në tabelë i keni të gjitha të dhënat sipas postës dhe tërheqjen e tyre.

Po ashtu, periudha tjetër e cila ka qenë dhe ka të bëjë me votuesit personat me nevoja të veçanta pra për të tri kategoritë i keni sikurse në raport periudhë e cila ka filluar me 18 gusht dhe ka zgjatur deri me 2 tetor pra për votuesit e ngujuar në shtëpi dhe numri i votuesve i regjistruar për këtë kategori është 1835, për votuesit me lëvizje të kufizuara në ndonjë institucion që ka përfunduar kjo periudhë me datën 2 tetor dhe numri i tyre është 1980 votues që janë me lëvizje të kufizuara në institucione; Po ashtu, e keni edhe në tabelë sipas të gjitha institucioneve sipas të gjitha regjioneve dhe klinikave e keni numrin e personave të regjistruar dhe kategoria tjetër, është për votuesit me nevoja të veçanta periudhë e cila ka përfunduar me 2 tetor dhe numri i tyre është 28.

Më lejoni të ju njoftoj se vlerësimi i pakove të dërguara për votuesit jashtë vendit do të filloj me datën 17 tetor pra nga ora 11 , do të punohet për këtë proces në dy ndërrimet dhe ky proces do të zhvillohet në objektin të cilin e kemi në Ministrinë e Infrastrukturës përkatësisht ku është i vendosur edhe shërbimi votues dhe do të filloj vlerësimi i pakove me fletëvotime të dërguara, në kuadër të përgatitjeve dhe furnizimeve me material zgjedhor nga logjistika e KQZ-së kemi konfirmimin që tashmë të gjitha materialet zgjedhore të ndjeshme dhe jo të ndjeshme janë shpërndarë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës pra tani kemi konfirmimin se janë pranuar edhe nga zyrtarët tanë komunalë dhe jemi në procesin e verifikimit në rast se mungon ndonjë prej artikujve. Pra sot me datën 16 tetor në orën 10 është bërë nisja e gjithë materialit të ndjeshëm për tu shpërndarë në të gjitha komunat e territorit të Republikës së Kosovës pra është fjala për fletëvotimet për kryetarë komune dhe kuvendin komunal bashkë me broshurat për kandidatë, listat përfundimtare të votuesve, vulat për fletëvotime dhe gjitha materialet tjera.

Në lidhje me fushatën zgjedhore për periudhën 29 ditore fushatë që ka zgjatur nga data 16 shtator deri me 15 tetor kemi pasur gjithsej 1023 kërkesa për tubime publike ku prej tyre 28 tubime publike janë mbajtur pa i përfillur rregullat zgjedhore si dhe vendimin e qeverisë së Republikës së Kosovës për masat anticovid ndërsa 207 prej tubimeve edhe pse janë paralajmëruar nuk janë mbajtur fare. Ndër aktivitetet për përgatitjen e zgjedhjeve sekretariati ka mbajtur edhe trajnimet e trupave zgjedhorë periudhë e cila ka filluar nga data 8 tetor dhe ka përfunduar deri me datën 15 tetor, ndërsa sot janë duke u mbajtur disa

trajnime plotësuese për trupat zgjedhorë të cilët zëvendësohen si rezultat i dorëheqjeve të komisionarëve.

Përgjatë këtyre 8 ditëve divizioni i trajnimit ka operuar në terren me gjithsej 142 ekipe të trajnimit ku prej tyre përgjatë këtyre ditëve gjithsej janë trajnuar 14.855 anëtarë të këshillave të vendvotimeve po ashtu janë trajnuar edhe 142 anëtarë të ekipeve mobile 242 anëtarë të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe 2477 kryesues të këshillave të vendvotimit.

Në raport, i keni të gjitha në detaje po ashtu edhe trajnimet e stafit të rezultateve preliminare proces i cili është përfunduar tani dhe janë trajnuar stafi të cilët do të raportojnë në ditën e zgjedhjeve për daljen e zgjedhjeve si dhe për rezultatet preliminare përmes projektit të rezultateve preliminare K-Vote është fjala për 833 qendra të votimit ku do ti dërgojmë stafin dhe si rezultat i numrit të madh të vendvotimeve në disa qendra është dashur patjetër ti dërgojmë dy apo tre staf që në total janë 914 staf të cilët janë dërguar për të raportuar në ditën e zgjedhjeve nga secila qendër e votimit për rezultatet preliminare dhe në fund e kemi edhe raportin për trajnimin e stafit të qendrës së numërimit dhe rezultateve trajnim i cili është zhvilluar me datën 14 dhe 15 tetor.

Trajnimi është zhvilluar po ashtu në qendrën e numërimit dhe rezultateve dhe janë trajnuar i gjithë stafi kështu që me këtë konsiderojmë që të gjitha përgatitjet e trajnimeve sa i përket trupave zgjedhore dhe stafit tjetër të angazhuar qoftë për rezultate preliminare dhe qoftë për rezultate përfundimtare janë përfunduar dhe tash ne jemi të gatshëm për të filluar me procesin zgjedhor pra më lejoni të ju ri konfirmoj edhe njëherë se të gjitha materialet janë shpërndarë në të gjitha komunat e territorit të Republikës së Kosovës dhe tani jemi duke i bërë kontrollat e fundit në mënyrë që në rast se ndonjë material mungon të mund ti përkrahim secilen komunë...

Sami Kurteshi: Faleminderit kryesohet për raportimin. Janë dy tri çështje të vogla, nuk janë të mëdhaja. Unë, dje kam bërë një pyetje: A janë bërë të gjitha përgatitjet dhe a janë ndërmarrë të gjitha veprimet prej anës së KQZ-së që gjithçka me qenë në rregull dhe e mora përgjigjen...Unë sot po pyes, a pritni çfarëdo pengese nesër që mund të lidhet me përgatitjet e KQZ-së, çfarëdo kjo është çështja e parë, ndërsa e dyta, i keni në faqe 6 të raportit tuaj në paragrafin e fundit, para pikës 8, dy elemente: një është 28 tubime nuk i kanë përfillur masat, kurse dje na keni premtuar se do të na dërgoni njëfarë raporti. Cilat janë subjektet dhe cilat janë shkeljet e tyre; Mirë kishte me qenë transparent deri në fund krejt me i ditë, le ti dinë publiku sepse kemi të bëjmë me subjektet. “Nuk ka shkelje të rënda” thoni në fjalinë e fundit, e keni një problem por ai s’është problem i madh, e thotë “fushata zgjedhore vazhdon, ka qenë e qetë...”, e herën e kaluar

keni thënë se “akoma është e qetë” ! Unë po besoj se deri në fund, ka për të shkuar e qetë, a është përmbyll krejt ?

Florian Dushi : Edhe unë në këtë frymë do të doja që sekretariati edhe KQZ jo vetëm për neve por edhe për opinionin të na njoftoj, madje propozoj që në fund kemi edhe një komunikatë për media ose një paraqitje tuajën z. kryesues dhe të garantojmë, të sigurojmë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që KQZ ka bërë gjitha përgaditjet dhe që presim nesër pjesëmarrjen në zgjedhje; Vendvotimet do të jenë të gjitha të hapura dhe presim po ashtu, që subjektet politike me të angazhuarit e tyre në trupa zgjedhore në vendvotime, të kontribuojnë në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Kjo është tepër me rëndësi dhe çështja të cilën deshta të pyes, jo për të bërë ndonjë ndarje por megjithatë kemi pasur disa situata si rezultat i veprimeve të organeve të drejtësisë dhe të rendit në disa komuna në pjesën veriore të Kosovës... Do të doja me dëgjuar nga krye shefi nëse gjithçka ka shkuar në rregull edhe në atë pjesë sa i përket shpërndarjes së materialeve, dhe organizimit të procesit zgjedhor.

Ibrahim Selmanaj: Mua më intereson me ditë, meqenëse ne jemi në rrethana pandemie për mos me i lënë asgjë rastit: Sa është përgaditë sekretariati, se nga ana e KQZ-së nuk kemi pas asnjë problem; Sa jemi të pajisur me nevoja të domosdoshme që janë edhe maskat edhe materialet tjera që shërbejnë ditën e zgjedhjeve në mënyrë që të garantojmë të gjithë votuesit kanë me pas një kujdes të veçantë dhe, nuk do ti lëmë asgjë rastit... ?

Alim Rama: Faleminderit krye shefit për raportin. Tash në bazë të raportit, ne po shohim se janë kryer pak a shumë të gjitha përgatitjet dhe, veç deshta të potencoj një pyetje për krye shefin, të konfirmoj se i gjithë stafi në QNR është trajnuar dhe janë marrë të gjitha masat që të mos përsëriten ato që kanë ndodhur në zgjedhjet e shkurtit. Po ashtu, isha lidhur me fjalën tuaj kryesues, kisha falënderuar të gjitha subjektet për një fushatë të qetë e po ashtu, i kisha ftuar të gjithë qytetarët për një pjesëmarrje masive edhe po ashtu të gjithë subjektet politike që të kontribuojnë që ky proces nesër të shkojë mbarë...

Ilir Gashi: Në bazë të raportit që e pamë, po shihet që ne jemi gati që nesër të fillojmë me ditën e votimit dhe po shpresoj që ashtu siç ka shkuar edhe fushata e qetë edhe dita e nesërme të jetë e qetë, ditë e mbarë ku qytetarët do ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar lirshëm për preferencat e tyre. Ajo çka kisha dashtë të bëj thirrje, pa dashtë me paragjyka: trupat zgjedhore dhe sidomos përfaqësuesve të subjekteve politike të jenë të vëmendshëm dhe të jenë vëzhgues të procesit por të mos tentojnë që dikush me e deformat vullnetin e qytetarëve të Kosovës, sidomos kur është në pyetje çështja e preferencave për kandidatë komunalë sepse, për subjekte dhe për kandidatura të kryetarëve, zakonisht ka kujdes më të

madh dhe nuk kemi pas pothuaj asnjë herë por deformimi i procesit. Zakonisht, ka ndodhur dhe ndodh për kandidatë dhe, unë kisha dashur shumë që në këtë pikë të jenë të vëmendshëm edhe organet qoftë ato të prokurorisë qoftë ato të rendit që të jenë të vëmendshme që ta përcjellin këtë proces sepse, të gjithë ata që do të jenë pjesë e manipulimeve të mundshme duhet me ditë që do të përballen edhe me prokurori, edhe me gjykata...

Cemajl Kurtis: Falem nderit, ishte një raport i ngjeshur. Dëshiroj ti falënderoj të gjithë kolegët në bashkëpunim, dhe Sekretariatit, si dhe ZRPP. Puna mendoj që është kryer, për aq sa edhe shihet, dhe mendoj se do të vazhdohet kështu...Falënderoj, sidomos për kontaktet dhe angazhimet e bëra me personat e hendikepuar, dhe se sipas kontakteve që kemi edhe ata janë falënderues. Besoj, do të vazhdohet në këtë drejtim edhe në zgjedhjet e ardhshme...Dëshiroj të theksoj se, duhet të kihet parasysh që përgjatë zgjedhjeve, në vendvotime të shkojë gjithçka në rregull, të mos ketë probleme dhe, ju uroj të gjithëve fat dhe sukses në zgjedhje...

Fazli Stollaj : Faleminderit për raportin sekretariatit i cili raport na ofron deri në detaje do të thotë se nesër në ditën e zgjedhjeve gjithçka është e përgatitur dhe është në rregull. Shpresoj në veçanti për trupat zgjedhorë të cilët janë trajnuar që në ditën e zgjedhjeve, do të jenë në nivel të detyrës. Ehe unë vetëm deshta të ju bashkangjitem kryesuesit në thirrjen që të gjithë të cilët kanë të drejtë vote nesër që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë dhe të kontribuojnë në një shoqëri demokratike.

Rifat Krasniq: Edhe unë bashkëngjitem parafolësve. Vetëm unë, e kam një porosi te subjektet politike edhe te komisionarët nëpër vendvotime: unë, si anëtar i KQZ-së dhe që vij nga komuna e Mamushës dhe në secilën komunë, ju dëshiroj sukses të gjithëve të gjithë kandidatëve që janë edhe për kryetar të komunave edhe anëtarë të asamblesë. Vetëm në komunën e Mamushës, e kam një porosi edhe për prokurorët, edhe për policinë që në Mamushë mundet me pas probleme...

Gordana Llaban: E shfrytëzoj rastin që ti falënderoj të gjithë, ndërsa përfaqësuesit e popullit të cilit unë i përfaqësoj, i thërras që të dalin në ditën e zgjedhjeve dhe ti zgjedhin përfaqësuesit e tyre më të mirë që na përfaqësojnë në institucione, pavarësisht nga situata e tanishme..

Burim Ahmetaj: Faleminderit! Pas të gjitha këtyre mesazheve të cilat e përçojnë mesazhin për zgjedhjet e lira të drejta dhe demokratike, më lejoni ti përgjigjem disa pyetjeve të cilat anëtarët e KQZ-së i ngritën dhe për të cilat do të japim edhe përgjigje. Në lidhje më përgatitjet dhe veprimet dhe a presim ndonjë pengese në procesin e ditës së nesërme sekretariati përkatësisht KQZ-ë ka bere të gjitha përgatitjet ka shpërndare të gjitha materialet zgjedhore neper secilën komune edhe tani jemi në procesin kur do të

verifikojmë se ndonëse na mungon ndonjë prej materialeve ose jo në mënyre që të furnizojmë dhe ti përkrahim më materiale gjate ditës së sotme përndryshe komisionet qendrore na kane konfirmuar së në gjithë territorin e republikës së Kosovës janë pranuar të gjitha materialet e ndjeshme dhe jo të ndjeshme të cilat do të shpërndahen tek kryesueset e vendvotimeve për secilin vendvotim dhe nga orët e hershme të mëngjesit të ditës së diele do të filloje edhe shpërndarja e tyre në mënyre që të marrin më veti në secilin vendvotim kështu që në aspektin e përkrahjes dhe logjistikes nuk shohim apo nuk presim ndonjë problem apo ndonjë pengese përveç pas verifikimit nëse mund të mungojë ndonjë artikull të cilët do të sigurojmë gjate ditës së sotme. KQZ-ë vazhdimisht i ka njoftuar qofte KKZ-të qofte zyrtaret komunal të zgjedhjeve po ashtu edhe gjate trajnimit vazhdimisht ka dërguar mesazhe për të gjitha ndryshimet procedurale të cilat KQZ-ë i ka marr gjate këtij procesi dhe besojmë në mase të madhe se këto mesazhe vetëm janë pranuar nga të gjithë komisionarët gjate seancave të trajnimit në mënyre qe të jene në kohe më të gjitha ndryshimet të cilat KQZ-ë i ka marr ndërsa në aspektin e sigurisë dje kemi qene në një takim të përbashkët të cilat mund të flas më shumë kryetari në aspektin e takimit të djeshëm që kemi pasur bashke më aktoret e memorandumit siç janë policia e Kosovës dhe Prokuroria e shtetit gjykatat ndoshta për këtë pjese kryetari mundet të flas më tepër në këtë aspekt mirëpo në aspektin e përgatitjes dhe përkrahjes jemi gjithçka në rregull dhe nuk na mungon asnjë material konsiderojmë së gjitha komunat i kane pranuar materialet dhe nuk kemi probleme asnjë komune.

Ndërsa sa i përket materialeve anti covid dhe masave anti covid KQZ-ë ka përgatitur po ashtu edhe fushate informuese se si të sillemi në ditën e zgjedhjeve qofte trupat zgjedhore apo edhe qytetaret, vazhdimisht KQZ-ë ka njoftuar së të gjithë komisionarët dhe të gjithë stafi të cilët punojnë në ditën e zgjedhjeve duhet të kenë si dëshmi vaksinën dhe kjo është vrenjtë së gjate trajnimit të trupave zgjedhore e kane dëshmuar edhe më certifikata të vaksinave apo më dëshmi tjera kështu që në aspektin e masave anti covid dhe të gjitha sjellëve sipas situatës pandemisë konsiderojmë që kemi marr të gjithë hapat e duhur. Ndërsa të pyetja më stafin e QNR-së kemi zhvilluar trajnime dy ditore për gjithë stafin e QNR-së, trajnim i ditës së dyte ka qene trajnim dhe simulimi mirëpo edhe trajnim i rifreskimit të procesit të trajnimit ajo së çka është më rendësi të shtoj këtu që KQZ-ë ka marr masa se secili proces të vëzhgohet më kamera gjate procesit të punës në QNR-ë, pra të gjitha njësit punuese apo vendet ku do të punohet procedohet materiali zgjedhore do të vëzhgohet nga kamerat e sigurisë të cilat janë të instaluar po ashtu edhe objekti është i monitoruar 24h më kamerat e vëzhgimit të objektit kështu që në aspektin e sigurisë edhe në aspektin e vëzhgimit i kemi marr të gjitha veprimet e duhura komforë vendimit të KQZ-vë, po ashtu kemi shtuar edhe masat e kontrollit të brendshëm dhe nuk do të lejojmë asnjë eksese në lidhje më këtë pune. Ndërsa për fund më lejoni nëse mundem te ja paraqes edhe numrin e shkeljeve apo edhe nëse doni për secilin subjekt

në lidhjet më shkeljet gjate fushatës zgjedhore, sipas raporteve të policisë për të cilat edhe policia e Kosovës ka ngritur dhe iniciuar raste për të gjitha këto nëse mundem të i lexoje atëherë, sipas raporteve nga policia e Kosovës, PDK i ka katër shkelje të masave anti covid. LDK katër, AAK dy , LVV shtatëmbëdhjetë, dhe të tjera një . pra këto janë sipas raporteve që i ka sjell policia e Kosovës dhe ka iniciuar raste për mos respektim të masave anti covid gjate fushatës zgjedhore kështu që nëse keni pyetje tjetër mund të ju përgjigjem.

Kreshnik Radoniqi : A ka pyetje tjera diçka lidhur më këtë? Jo, ka nevojë diçka lidhur për sigurinë më qene se polica e ka gjithë operacionin e ka ndërmarr d.m.th, ka bërë përgatitjet operacionale për sigurinë gjatë zgjedhjeve, por edhe prokuroria janë mobilizuar gjithashtu edhe gjykatat dhe kanë caktuar gjyqtare kujdestar në secilën gjykatë dhe degë të saj që do të punojnë në ditën e zgjedhjeve, po ashtu edhe prokuroria; secila prokurori ka caktuar prokurorët kujdestar në secilin qytet.

Sami Kurteshi: Më duket z. Dushi ka propozuar, ju më korrigjoni nëse nuk është ashtu: është kërkuar që nesër, së paku, t'u lejohet mediave në një moment të caktuar që ta vizitojnë dhomën e operacioneve. Ju do të mundësoni ata që të shohin njerëzit që ajo është aktive si veprohet dhe janë marr të gjitha veprimet në atë drejtim...?

Kreshnik Radoniqi: Nesër mëngjes pasi që fillon puna, mediat do të kanë mundësi që të marrin filmime dhe do të shohin se si funksionon dhoma operative....

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Yll Buleshkaj : Faleminderit shumë i nderuar kryesues të nderuar anëtar, fillimisht ju njoftoj se të gjitha punët që janë mbetur pa kryer nga zyra tash më janë kryer përveç rekomandimit që keni para jush pak para dreke kemi pranuar një raport i cili na liston diku 483 vëzhgues të cilët i kemi akredituar po të cilët tashme e kanë edhe një detyrë tjetër nga KQZ-ja qofte si staf i këshillave të vendotimeve, qendrave të votimit apo si staf i sekretariatit, për shkak që legjislacioni në fuqi nuk lejon që të kryen dy funksione të njëjtën kohe atëherë kemi paraqitur para juve një kërkesë rekomandim për tërheqjen e akreditimit të këtyre 483 vëzhguesve të cilët vine edhe nga subjektet politike, nga OJQ dhe nga mediat pra gjithë nga këta e kanë edhe një punë tjetër e cila është caktuar më vendim të KQZ-së arsyeja pse besojmë që është

më së miri që të tërhiqet akreditimi si vëzhgues e jo caktimi si anëtar i këshillave të vendvotimit është sepse shumica nga ta tashme e kanë ndjek trajnimin dhe një vendim i tillë ndoshta kish ndikuar negativisht në proces sesa ky i cili e kemi paraqitur para jush e kemi edhe draft rekomandimin më listën e të gjithë atyre personave të cilët janë gjetur po ashtu e kemi edhe draft vendimin i cili po ashtu e përmban listën. Faleminderit !

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, z, Dushi, pastaj z. Elashni ?

Florian Dushi: Faleminderit Kryeses, një pyetje e kisha për zyrën sepse është tepër më rendësi tani kjo situatë të sqarohet deri në fund a kemi mundësi që na sot më i njoftuar subjektet politike për faktin edhe më i tërheqë ID e tyre që ja kemi prodhuar ose më i shpall të pa vlefshme në njëfarë forme sepse ata nesër mundën me u gjete nëse nuk i njoftojmë më kohe mundën me u gjete neper vendvotime të caktuara ndërsa ne e kemi vendimin më e tërheqë akreditimin e tyre. Prandaj, kjo edhe në raste të ndonjë problemi që mundet më e pas më organet e rendit apo më organet e drejtësisë kjo mandej shkon vetëm duke e rrit problemin në fjale prandaj ju kish lute që të i njoftoni subjektet politike dhe që të kërkoni prej tyre që ato të i tërheqin ID e tyre ose ti mbajnë në seli të tyre qendrore ose ti kthejnë në zyre brenda mundësive sepse është periudhe e shkurt kohore ndoshta edhe nuk kanë mundësi këtë kohe kur ato janë duke u marr më përgatitje tjera faleminderit.

Arianit Elshani: Unë, sa po u njoftova edhe nga administrata e PDK-së se disa të cilët janë listuar më qene se nuk e pata këtë liste më herët, disa prej të cilëve janë të listuar këtu, realisht nuk kanë shkuar, nuk kanë marrë pjesë fare në trajnime edhe pse kanë konfiguruar të komisionarë në listën e komisionarëve, dhe janë bere këto ndryshime prandaj, mendoj që para së të votohet kjo, fillimisht duhet ti hidhet një sy të gjithë atyre listave që vijnë nga terreni. Pra nga KKZ-ë që të verifikohen saktë se këta persona figurojnë pra si komisionarë që mos t'i hiqet mundësia dikujt, edhe mos të jetë si vëzhgues për shkak që ka qenë para dy javësh në këto lista sepse, secili subjekt këto ndryshime i ka bërë deri më sot, deri në ora dhjete që e zgjatëm afatin për KKZ-të. Mendoj se duhet t'i hidhet një shikim në ato lista të përditësuar të komisionarëve sepse, pash që figurojnë disa persona që realisht nuk janë fare të angazhuar në KVV, dhe që nuk kanë qenë më parë në këto lista. Këtë e kame si kërkese para se të akreditohen këta si vëzhgues...

Kreshnik Radoniqi: Dikush tjetër...?

Yll Buleshkaj: Sa i përket kërkesës së z. Dushi, është shumë e drejtë. Ne, posa që të merret vendimi do të njoftojmë të gjitha subjektet politike me emrat e tyre dhe, si me numrin e dokumentit identifikues; mundësisht të kthehet edhe tek ne; të njëjtën mundem më ndarë edhe me institucionet e rendit nëse ka

pastaj ndonjë problem të rendit, dhe janë të informuar që këta persona nuk janë tash më të akredituar si vëzhgues. Ka nga vëzhguesit të cilët janë të angazhuar edhe si stafe i sekretariatit, tashmë e ka të tillë që kane qene edhe në media edhe në parti politike ka edhe në OJQ-ë parti politike edhe staf i jon. Kështu që verifikimin që e kemi bërë, e kemi bërë sot në ora 12, dhe e di që verifikimi është bërë me kërkesë për aprovime që janë dërguar te dokumentet identifikuese të anëtareve të këshillave të vendotimit sepse, atë e kemi konsideruar si data bazën më të besueshme...

Ibrahim Selmanaj: Një pyetje: A bëhet fjalë për angazhime që janë bërë angazhimet si staf jo permanent, dhe a ka të bëjë më të njëjtit njerëz...?

Alim Rama: Me sa kuptova unë, të gjithë këta persona e kanë vetëm edhe ID për këshillin e vendotimeve, mendoj kanë ID, kështu që unë mendoj se nuk na vyen as me prit në të vërtetë se, këta nuk mundet një person ndoshta është staf i QNR-së ku janë 700 përafërsisht, është edhe stafe në komune kështu që unë mendoj se nuk duhet më pritë po me u aprovuar këta që të hiqen të gjithë këta vëzhgues, pavarësisht në qofte se janë shtypur ID, ai personi i cilido qofte subjekti politik (nuk dua më ndërhy) ai ka tentuar me kanë komisionar me një subjekt tjetër. Kjo, automatikisht lidhet me konflikt interesi kështu që unë pavarësisht verifikimit deri më tani, mendoj se të gjithë këta duhet më iu heqë akreditimi...

Arianit Elshani: Materiali, është dorëzuar sot nëpër qendrat e votimit apo, sot ka shkuar në qendra të votimit dhe nesër në mëngjes do të tërheqin ato komisionarët listat nga KKZ-të; janë pritur deri sot në ora dhjetë, kështu që listat e përditësuara të KVV-ë janë sot dhe këtu, po e kuptoj që janë bërë në ora 12 por, vetëm të shikohet edhe njëherë mos ka ndonjë lëshim...; Unë thash në raport me disa të PDK-së ka lëshime që nuk janë fare si komisionar... Pra, atyre ua tërhiqni, i shpallni të pa vlefshme edhe ato bexha të cilët, ata i kanë, pra që janë në KKZ –ë dhe në qendra të votimit që do të menaxhohen nga kryesuesit...

Kreshnik Radoniqi: Mua, nuk po me duket që ka shumë kohë dhe na duhet sot dhe me ba njoftime, edhe me kërkuar tërheqjen e këtyre bexhave...

Sami Kurteshi: Unë, e kuptoj që janë afër 500 persona dhe mundet me u bërë ndonjë lëshim, unë e dëgjova z. Elshani dhe pajtohem. Ne, duhet me e gjet një mënyre qysh me ec përpara me këtë punë... Si do qoftë, unë mendoj që mire është me miratuar këtë dhe më ja dërguar subjekteve politike, dhe me ju thanë keni kujdes dhe dërgojani sekretariatit emrat...

Yll Buleshkaj: Po besoj që kjo është e mundshme...!

Burim Ahmetaj: Edhe në këto momente kur po mbahet mbledhja e KQZ-së, janë duke u bërë zëvendësime të anëtareve të këshillave të vendvotimeve kështu që, duhet patjetër edhe kjo pjesë të krahasohet, të mos ketë lëshime...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, atëherë nëse s'ka dikush diçka tjetër, unë e hedh në votim rekomandimin për tërheqjen e akreditimit të vëzhgueseve. Kush është për ?

Në mënyrë unanime aprovohet rekomandimi për tërheqjen e akreditimit të vëzhguesve për zgjedhjet lokale që mbahen më 17 tetori 2021.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve përfundimtare të KVV-ve, për zgjedhjet lokale 2021:

Nexhmedin Hyseni: Faleminderit kryetar, paraprakisht nga debatet që u zhvilluan po dëshirojmë të ju njoftojmë nga tereni nga të gjitha komisionet komunale të zgjedhjeve, përveç këtyre statistikave që i kemi para nesh që KKZ-të përmes subjekteve politike që kane pranuar kërkesat për zëvendësimet të anëtareve të këshillave të vendvotimeve. Ne, e kemi tashme edhe disa për momentin që erdhën nga shërbimi korrektues që prej 14 ekipeve mobile që do të operojnë neper qendrat e paraburgimit dhe qendrat korrektuese 6 persona duhet të ndryshojnë për shkak së ju ndalohet të kenë qasje neper qendrat të paraburgimit kemi rastin e Prizrenit Gjilanit, Pjesës edhe Istogut ata persona i kemi njoftuar KKZ-të e komunave përkatëse edhe subjektet politike që deri në ora 14:30 të ndryshojnë edhe të i zëvendësojnë ata persona që të kenë të drejt zëvendësimi nesër ne ato ekipe mobile përveç këtyre 6 personave që nuk janë përfshirë në tabele i kemi tani 261 që kane ardhur nga tereni e akoma kërkesat po rrjedhin nga subjektet politike e sidomos tashme që në Prishtinë kemi kërkesa nga një subjekte politike që disa kryesues nuk kane ardhur me e marr materialin jo sensitive për vendvotimet. Si rrjedhojë e kësaj aktualisht, i kemi 261 zëvendësime dhe 28 plotësime dhe si pasoje e kësaj tashme është një pune e mire që KQZ-ë jua ka mundësuar KKZ-vë se në secilin vendvotime ku ka mungesa të anëtareve të këshillave të vendvotimit, KKZ-ë në tersi ka te drejt vendim marrje për më i plotësuar ato vendvotime.

Përveç kësaj, tha z. Hyseni edhe një njoftim: stafi teknik. sot kemi disa menaxhere që janë tërheq për shkak të infektimit më covid edhe disa për arsye personale po është pune që e administron KKZ-ja por jo për vendim marrje nga KQZ-ë por kemi kësi raste që për arsye personale edhe arsye objektive njerëzit janë tërmekur më vete dëshire , më vullnet janë paraqitur në zyrat e KKZ-vë tani për tani kemi 261

zëvendësime dhe 28 plotësime deri në këto momente që po flasim. Sa i përket asaj 6 nominimet e reja që do sjellin subjektet politike përmes KKZ-vë, duhet të i ridërgojmë përsëri në shërbimin korrektues respektivisht në ministrinë e drejtësisë për verifikimin e tyre dhe pastaj do të njoftohen subjektet politike, dhe sot pasdite do të trajtohen ata persona të ri që përcakton KKZ-ja.

Sami Kurteshi: U përpoqa me përcill më vëmendje, por me tregu drejt nuk mundem shumë me i ra në fije, po 261 zëvendësime...Për mua, kjo është pune teknike pak e shtuar por, është një shenjë shumë e mire. Unë, kam qenë në teren dhe me komisionarët kom bërë përpjeke shumë, edhe prej tyre më janë shpjeguar disa ndryshime por, edhe me ja tërheq vëmendjen se nuk ka më pasur asnjë lëshim për ata që janë në vendvotime që bëjnë lëshime qysh janë bere përpara dhe, me u rinumëruar 35% të kutive... Dhe unë po them se me vesh të mi e kam dëgjuar se shumë njerëz kanë filluar me u frikuar dhe kjo është shumë e mirë, se ata kanë menduar se shkojnë aty, rrinë me i marrë do para, dhe s'ka kurrfarë përgjegjësie. Jo, ka përgjegjësi secili komisionar; le ta marrin seriozisht punën dhe përgjegjësinë që kanë pasur përpara sepse, është e pa lejueshme në çdo parë zgjedhje ne me i pas 30/35% apo 40% të vendvotimeve apo të kutive të vendvotimeve të rinumëruara. E dyta, e tërhoqi vrenjten edhe z. Gashi jo kandidatet, jo andej këndeje, unë po e shoh ketë si shenjë të mire. A ka më qene ky hapi parë nuk e di, por kjo është si shenje shumë e mirë...

Nexhmedin Hyseni: Lidhur më ketë që tha z. Kurteshi, KKZ-të për secilin prej këtyre, kanë marr tre vendime: një kopje për anëtarin e zëvendësuar, një kopje për zyrën e KKZ-së edhe një kopje kanë dorëzuar në sekretariatit e KQZ-së që për secilin, i kemi tri dëshmi që KKZ-të e kanë marr vendime përkatëse...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse s'ka diçka tjetër, kush është për miratimin e këtyre zëvendësimeve. Me 10 vota, miratohen...

5.Të ndryshme!

